P.nr.572/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, ***Departamenti i Përgjithshëm***, *përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me Zyrtaren Ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuares D.O. nga fsh. ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm,PP.II.nr. 866/2015, e datës 10.06.2015 të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Ismet Ukshini, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 04.12.2017, mori dhe shpalli këtë :*

A K T GJ Y K I M

E akuzuara ***D.O.*** *nga babai M. dhe nëna M., e lindur T., e lindur më data e lindjes..., në ... tani jeton në fsh. S... K. ..., e martuar, nene e tre fëmijëve, din shkrim dhe lexim, e gjendjes së varfër ekonomike, Serbe, Shtetase e Republikës së Kosovës, nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë vepër tjetër penale,*

Është fajtor
Sepse

-prej datës se pavërtetuar e deri me datën 24.11.2014, në kohë të papërcaktuar, në shtëpinë e tij në fsh. ... K. ..., në mënyrë të vazhdueshme dhe të pa autorizuar ka përfituar nga shërbimi komunal-rrjeti i shpërndarjes së rrymës së ...-it, në atë mënyrë që në njehsorin e tij elektrik me nr. ..., në atë mënyrë që në këtë njëhësor pëmes qelqit nga ana e jashtme ka futur një copë të plastikës ka penguar punën e diskut për ta regjistruar rrymën e shpenzuar elektrike, m ç'rast ...-in Distriktin në ... e ka dëmtuar për shumën e të hollave në vlerë prej afërsisht 31.54 eurove.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 i KPRK-së.

Andaj,gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21, 49, 50,51,52 e 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 e 451 dhe 463 të KPPRK-së, asaj i shqipton:

DËNIM KUMULATIV ME KUSHT

*Ashtu që të pandehurës D.O., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **180 (njëqindetetëdhjetë) ditëve** si dhe dënim me gjobë në shumë prej **150€ (njëqind e peshëdhjetë euro**), të cilat dënime e pandehura nuk do t'i mbajë, gjegjësisht nuk do ta paguaj, nëse në afat prej **1 (një) viti,** nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.*

Pala e dëmtuar ...-Distrikti ne ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet e pandehura që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, , si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehuës D.O. nga fsh. ... K. ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, dhe publik të mbajtur më datë 24.10.2017 Prokurori i shtetit Shefik Mehmeti deklaron: se e pranon pranimin e fajësisë nga e akuzuara për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barë duke i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë si dhe privilegjet e saj, andaj propozoj gjykatës se në raste të ndonjë shqiptimi të merr parasysh si rrethanat lehtësuese gjendja e varfër ekonomike, i papunë, pranimin e fajësisë premton se në të ardhmen nuk do të kryej asnjë vepër të tillë penale dhe të tjera, ndërsa si rrethanë rënduese, i propozoj gjykatës që të merre parasysh shkallën e përgjegjësisë penale.

E pandehura D.O., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, dhe se pranon fajësin për veprën e cila i vihet në barrë, dhe e lut gjykatën që t'ia shqiptoj në dënim sa më të butë.

Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase e pandehura e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të

fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga e pandehura; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se e pandehura D.O. nga fsh. ... K. ..., me dashje e ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehuren D.O. nga fsh. ... K. ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale , nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurës D.O., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuse, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, se është familjare prinde e tre fëmijëve, e gjendjes së varfër ekonomike, ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurës D.O., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPK

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 04.12.2017

Zyrtarja Ligjore ***Gjyqtari i vetëm gjykues,***
Florentina Ademi ***Ramiz Azizi***

***KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*